Projekti: “Ndjekja dhe verifikimi i premtimeve të fushatës zgjedhore në Shqipëri”

Projekti ndihmon qytetarët shqiptarë që të gjejnë dhe rregjistrojnë premtimet elektorale të politikanëve shqiptarë. Projekti ofron mjete dhe mundësi për të verifikuar realizimin e këtyre premtimeve.

Qëllimi është që të mbahen nën përgjegjësi lidhur me premtimet deputetët e parlamentit shqiptar dhe të zgjedhurit lokalë, kryetarët e Bashkive.
Këtij qëllimi i shërben përgatitja e buxheteve qytetare, që janë versione të thjeshtuara të buxheteve bashkiake për vitin 2020. Nëpërmjet këtyre buxheteve qytetarët do të kuptojnë më mire mënyrën e shpenzimeve dhe se si shpenzohen taksat e tyre.

Ju lutemi të gjeni në këtë document buxhetin e thjeshtuar qytetar të Bashkisë Fushë Arrëz.
Gjatë takimit të sotëm të këtij fokus grupi do të përpiqemi të kuptojmë se sa i thjeshtë dhe i kuptueshëm është buxheti qytetar. Ju lutemi shprehni mendimet dhe sugjerimet tuaja që të përmirësojmë këtë dokument dhe ta paraqesim përpara qytetarëve të Bashkisë Fushë Arrëz.

Ju falenderojmë për mbështetjen dhe bashkëpunimin!

Buxheti Qytetar i Bashkisë Fushë Arrëz, Viti 2020:

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2020

Studimi ka për qëllim të analizojë parashikimin për të ardhurat e vitit 2020, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.
BazuarnëLigjin nr. 9632, "Për sistemin e taksave vendore", bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë.

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve, /000 lek

Burimet e financimit	2019	2020	Diferenca 2020-2019
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	75,829.00 (42%)	80,726.00 (29%)	4,897.00
Transferta e Specifike (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	74,987.00 (42%)	74,987.00 (26%)	-
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	28,555.00 (18%)	28,555.00 (10%)	-
Transferat të kushtëzuara (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)		98,018.00 (34%)	98,018.00
TOTALI	**179,371.00**	**282,286.00**	**102,915.00**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Grafik 1. Të ardhurat totale, Fushë Arrës2019



Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Grafik 2. Të ardhurat totale, Fushë Arrëz 2020



Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Grafik 3 Burimet e financimit për vitin 2019-2020



Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Më poshtë është dhënë parashikimi mbi të ardhurat nga taksat dhe tarifat, dhe nga të ardhurat e tjera nga Bashkia Fushë Arrës.

Tabela 2. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat

Nr.	Të Ardhurat e veta	Plan 2019 në 000/lekë	Plan 2020 në 000/lekë	Diferenca 2020-2019	% mbi totalin e të ardhurave vendore 2020
1	Të ardhurat nga Taksat Lokale	10,172.00	10,172.00	-	36%
2	Të Ardhura nga Taksat e Ndara	4,573.00	4,573.00	-	16%
3	Të Ardhura nga Tarifa Vendore	7,210.00	7,210.00	-	25%
4	Të Ardhura të tjera	6,600.00	6,600.00	-	23%
	TOTALI	**28,555.00**	**28,555.00**	**-**	**100%**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Tabela 3. Lista e taksave vendore (detyrime që paguajnë qytetarët për shërbimet e marra nga Bashkia)

(Bilanci 2019 është i pritshëm, pasi sipas Ligjit mbi dorëzimet e bilanceve, bilanci i mbyllur i vitit 2019 dorëzohet deri më 31 Mars 2020. Më pas del vlera reale).

TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE						
Nr.	**Lloji i taksës**	**Plani i pritshëm 2019 në 000/lekë**	**Plani 2020 në 000/lekë**	**Diferenca në vlerë 2019 -2020**	**Diferenca në % 2019 -2020**	**% mbi totalin e të ardhurave vendore 2020**
2	Taksa mbi ndërtesën	8,313	8,313	-	0	29.11
3	Taksa mbi tokën bujqësore	620	620	-	0	2.17
4	Taksë mbi truallin	412	412	-	0	1.44
5	Taksa e fjetjes në hotel	21	21	-	0	0.07
6	Taksa e ndikimit në infrast.	600	600	-	0	2.10
7	Taksa e Parkingu	206	206	-	0	0.72
TOTALI		**10,172**	**10,172**	**-**	**-**	**35.62**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Tabela 4. Lista e tarifave vendore (detyrime fikse që paguajnë qytetarët për shërbimet e marra nga Bashkia)

Nr.	**Lloji i taksës**	**Plani i pritshëm 2019 në 000/lekë**	**Plani 2020 në 000/lekë**	**Diferenca në vlerë 2019 -2020**	**Diferenca në % 2019 -2020**	**% mbi totalin e të ardhurave vendore 2020**
1	Tarifa mbi menaxhimit te mbetjet	2,500	2,500	-	-	8.76
2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	-	-	-	-	-
3	Tarifa për ndricimin publik	380	380	-	-	1.33
4	Tarifë gjelbërimi	-	-	-	-	-
5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	3,710	3,710	-	-	12.99

6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	620	620	-	-	2.17
	Tarifa e përkohëshme				-	-
7	Të tjera			-	-	-
TOTALI		**7,210**	**7,210**	**-**	**0.0**	**25.25**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Tabela 5 Lista e të ardhurave të tjera vendore

Nr.	Lloji i taksës	Plani i pritshëm 2019 në 000/lekë	Plani 2020 në 000/lekë	Diferenca në vlerë 2019 -2020	Diferenca në % 2019 -2020	% mbi totalin e të ardhurave vendore 2020
1	Qeraja dhe asetet në pronësi	6,600.00	6,600.00	-	-	23.11
TOTALI		**6,600**	**6,600**		**-**	**23**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Tabela. 6 Lista e të ardhurave nga taksa e ndarë

Nr.	Lloji i taksës	Plani i pritshëm 2019 në 000/lekë	Plani 2020 në 000/lekë	Diferenca në vlerë 2019 -2020	Diferenca në % 2019 -2020	% mbi totalin e të ardhurave vendore 2020
1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	-	-	-	0.0	0.00
2	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	1,300.00	1,300.00	-	0.0	4.55
3	Taksa e rentës minerare	3,273.00	3,273.00	-	0.0	11.46
4	Taksa të tjera	-	-	-	0.0	0.00
TOTALI		**4,573.00**	**4,573.00**	-	**0.0**	**16.01**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Tabela7 Lista e të ardhurave nga buxheti qëndror

Nr.	Përshkrimi	Plani i pritshëm 2019 në 000/lekë	Plani 2020 në 000.lekë	Diferenca në vlerë 2019 -2020 në 000/lekë	Diferenca në % 2019 -2020	% mbi totalin e të ardhurave 2020
1	Trasferta të pakushtëzuara	75,829.00	80,726.00	4,897.00	6.457951443	28.60
2	Trasferta të kushtëzuara	95,888.00	98,018.00	2,130.00	2.221341565	34.72
3	Trasferta specifike	74,987.00	74,987.00	-	0	26.56
TOTALI		**246,704.00**	**253,731.00**	**7,027.00**		**89.88**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Grafik 4. Të ardhurat vendore



Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Grafik 5 Të ardhurat vendore si % mbi totalin e të ardhurave vendore



Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Një element tjetër i rëndësishëm për të ardhuratnëbuxhetin e bashkive është edhe transferta e pakushtëzuar dhe ajo specifike, e cila ndihmon ndjeshëm njësitë vendore në përmbushjen e planeve të investimeve dhe shpenzimeve.

Tabela 6. Transfertat qeveritare (fonde të deleguara nga Qeveria për Bashkitë)

Emërtimi	2020 në 000/lekë	% mbi Tot. Ardh.
Transferta e pakushtëzuar	80,726.00	29%
Transferta specifike	74,987.00	27%
Transferta të kushtëzuara	98,016.00	35%
TOTALI	**253,729.00**	**90%**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Fushë Arrëz për vitin fiskal 2020

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?
Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2020.

Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 7. Shpenzimet totale tëBashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Shpenzimet	2019	2020	Dif. 2019-2020	% mbi Tot. Ardh.
Shpenzime korrente	39,501.00	136,053.00	96,552.00	**48.2%**
Shpenz.Kap.	0.00	0.00	0.00	**0.00%**
Shpenz.paga + sigurime	139,870.00	146,233.00	6,363.00	**51.8%**
TOTALI	**179,371**	**282,286.00**	**102,915.00**	**100.00%**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Grafik 7. Diferenca e shpenzimeve për vitin 2019-2020



Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Grafik 8. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar shpenzimet, që iu shtuan Bashkisë Fushë Arrëz si rezultat i Reformës Administrative dhe Decentralizmit Fiskal. Që nga viti 2015 Bashkitë kanë më shumë kompetenca për t'i shërbyer qytetarëve të tyre.
Është vënë re që Bashkia Fushë Arrëz për vitin 2020 nuk ka parashikur në buxhetin e saj shpenzime kapitale.

Tabela 10. Shpenzimet sipas programeve dhe si % ndaj Tot.të ardh.vendore

Shpërndarja e buxhetit sipas programeve	Vlera në 000/lekë	% ndaj TA vendore
Planifikimi Menaxhimit dhe Administrimit	75,691.00	26.81%
Shërbimet Policore	2,535.00	0.90%
Mbrojta nga zjarri dhe mbrojtja civile	14,107.00	5.00%
Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi	13,459.00	4.77%
Transsporti	13,388.00	4.74%
Menaxhimi i Mbetjeve	7,816.00	2.77%
Zhvillimi në kominitet	13,158.00	4.66%
Ndricimi i Rrugëve	1,142.00	0.40%
Arsimi baze përfshin arsimin parashkollor	34,301.00	12.15%
Arsimi i Mesem i Përgjithshëm	5,304.00	1.88%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	99,145.00	35.12%
Strehimi social	240.00	0.09%
Fondi i kontigjencës + Rezervës	2,000.00	0.71%
TOTALI	**282,286.00**	**100.00%**

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz, (llogaritje EIC)